



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-p.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/83
Datë: 5 / 9 / 2025

Senati i Universitetit të Prishtinës, në kuadër të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 148, nenit 151, 152 dhe 153 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Rregulloren me nr. prot. 1/282, të datës 03.06.2025, për procedurat për zgjedhëse lidhur me emërimin, avancimin dhe rizgjedhjen e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës, në bazë të kërkesës së Këshillit të Fakultetit të Filologjisë, në mbledhjen e mbajtur më 27.08.2025, vendosi të:

shpallë

K O N K U R S

për emërimin e personelit akademik në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës

I. FAKULTETI I FILOLOGJISË

Emërimet për herë të parë në thirrjen përkatëse:

1. Një mësimdhënës për studimet bachelor në Ballkanistikë, për lëndët: Varietetet e gjuhës së sotme ballkanike, Gjuhë e sotme ballkanike I (Kurs gjuhe – niveli A2), Gjuhë e sotme ballkanike II (Kurs gjuhe – niveli B1), Religjionet në ballkan, Kontaktet e gjuhëve.
2. Një mësimdhënës për lëndët: Hyrje në teoritë kulturore (MA Orientalistikë), Teoria postkoloniale, (MA Orientalistikë), Shkrim akademik (për jo shqipfolësit) (BA Ballkanistikë), Historia e ballkanit të lashtë (BA Ballkanistikë), Histori bizantine e ballkanit (BA Ballkanistikë), Historia e re e ballkanit (BA Ballkanistikë).

KUSHTET E PËRGJITHSHME

I. Kushtet e përgjithshme për emërim, riemërim ose avancim të personelit akademik janë të përcaktuara në dispozitat e Statutit të UP-së dhe Rregulloren nr. 1/282, të datës 03.06.2025, për procedurat për zgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës.

II. Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 - a) Kërkesën për aplikim;
 - b) Biografinë (CV);
 - c) Certifikatën/ekstratin e lindjes;
 - d) Kandidatët që janë të punësuar në UP me rastin e konkurrimit për avancim në thirrjen akademike të profesorit asistent duhet ta dorëzojnë diplomën origjinale të doktoratës ose kopjen e saj të vërtetuar nga noteri, ose vendimin për nostrifikimin (barasvlerën) e diplomës së doktoratës/dëshminë e aplikimit për nostrifikim. Kandidatët të cilët konkurrojnë për riemërim në pozitën e asistentit, nëse nuk kanë doktoruar ende, duhet të sjellin dëshminë e regjistrimit të studimeve të doktoratës;
 - e) Kandidatët që janë të punësuar në UP duhet të paraqesin vendimin e emërimit të fundit;
 - f) Dëshmitë për: monografitë; referencat përkatëse për mësimdhënie; tekste mësimore; pjesëmarrje në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme; mentorime; pjesëmarrje në konferenca shkencore; publikimet shkencore e profesionale; shërbimin për Universitetin, fakultetin dhe komunitetin etj., brenda kornizës së përcaktuar me Statutin e UP-së dhe Rregulloren në fuqi për emërim, riemërim dhe avancim të personelit akademik. Linku: <https://dokumente.uni-pr.edu/>;

Kandidatët të cilët nuk janë të punësuar në UP, përveç dokumenteve nën pikat a), b) c) dhe f) duhet t'i sjellin edhe:

- g) Diplomat origjinale ose kopjet e diplomave (baçelor, master, magjistraturë dhe doktoratë) të vërtetuara nga noteri;
- h) Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit për zgjedhje, rizgjedhje apo avancim duhet të sjellin vendimin për nostrifikimin (barasvlerën) e diplomës përkatëse (baçelor, master, magjistraturë, doktoratë) ose dëshminë e aplikimit për nostrifikim;
- i) Kandidatët të cilët pretendojnë të themelojnë marrëdhënie të rregullt pune për herë të parë në UP, duhet të sjellin dëshmi nga Gjykata Themelore përmes se cilës dëshmojnë që nuk janë të dënuar dhe që nuk janë nën hetime;
- j) Dëshmitë për përvojën e punës të realizuar në institucione dhe programe të akredituara të arsimit të lartë.
- k) Informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë; dhe
- l) Deklaratën me shkrim për gatishmëri të dorëheqjes nga vendi i punës paraprak në rast të emërimit nga Senati.

III. Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim

1. Të gjitha emërimet për tituj, si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të Universitetit të Prishtinës.
2. Avancimi përkatësisht riemërimi nuk është proces automatik, por është konkurrues dhe i bazuar në kriteret e Statutit të UP-së dhe të rregulloreve në fuqi lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik.
3. Në rast të mungesës së vendimit për nostrifikim të diplomës në kohën e aplikimit për emërim, riemërim ose avancim, kandidati është i obliguar që së paku 3 ditë para se Senati të vendos për lëndën përkatëse, të sjellë vendimin për nostrifikim të diplomës/ave, në të kundërtën kandidatura do të refuzohet.
4. Bazuar në Ligjin e Punës në fuqi, kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vjet, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.
5. Bazuar në Statutin e UP-së pjesa që ka të bëjë me konfliktin e interesit është e shprehur në mënyrë taksative dhe është e obligueshme gjatë procesit të emërimit/rekrutimit.
9. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas Ligjit të Punës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

IV. Vendimi, periudha e ankimimit dhe e përmbylljes së konkursit

1. Procedura e përgjithshme e realizimit të konkursit përcaktohet me dispozitat e Rregullores me nr. 1/282, dt. 3.6.2025, për emërim, riemërim ose avancim të personelit akademik janë të përcaktuara në dispozitat e Statutit të UP-së.

V. Mënyra e aplikimit

1. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë elektronike.
2. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në emailin e fakultetit përkatës dhe në platformën online të Universitetit të Prishtinës stafiakademik.uni-pr.edu.
3. Punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare nuk ka nevojë të skanohen në tërësi, por vetëm faqja e parë dhe e fundit e punimit (përfshirë konkluzionet), ndërsa për libra, tekste mësimore dhe monografi të botuara duhet të skanohet faqja e parë e librit dhe faqja në të cilën shihen recenztët dhe katalogimi në botim (CIP).
4. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartcekur, nuk do të merren në shqyrtim.
5. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, përkatësisht **nga data 05.09.2025 deri më 19.09. 2025, në orën 16⁰⁰**.

